



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.649/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.649/2026, të datës 19.06.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencia e Regjistrimit Civil, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.649/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi A.M.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr.73/2026, i datës 09.06.2026, i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrimin Civil.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*) më datë 19.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.73/2026, të datës 09.06.2026, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrimin Civil, për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 23.06.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.07.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) **për vendosje meritore në këtë lëndë administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2748/2026 të datës 19.06.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 94/2020 të datës 06.02.2020 për pezullim nga puna;

Vendimin me Nr. 73/2026 të datës 09.06.20226 për sistemim të ankuesit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Renda me shirën 2021:229664; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 02.07.2026; Akt Emërimit të datës 31.01.2013; Vendimin për emërim të datës 05.01.2011; Kërkesë për kthim në vendin e punës e datës 30.07.2021.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr.Ref:ARC-1/13 të datës 31.01.2013, mbante pozitën Kryeinspektor i Inspektoratit në Agjencinë e Regjistrimit Civilë.

Me Vendimin me Nr. 94/2020 të datës 06.02.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është pezulluar nga puna me pagesë prej 50% të pagës për shkak të dyshimit për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Marr për bazë sipas shkresave të lëndës, respektivisht sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ankuesi është liruar nga akuza, pas kërkesës së datës 15.05.2026 për kthim në vendin e punës, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil më datë 0-9.60.20265, ka nxjerr Vendim me Nr. 73/2026, me të cilin ankuesin e ka sistemuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Mbështetje të QRA në Drejtoratin për Regjistrim të Automjete në Agjencinë e Regjistrimit Civil, me konstatimin se pas ndryshimeve organizative nuk ekziston mundësia e rikthimit në të njëjtën pozitë që ka qenë para pezullimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr.73/2026, të datës 09.06.2026, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrimin Civil, pretendon se pozita që ka mbajtur vetëm i është ndryshuar emërimit dhe mënyra e raportimit dhe e cila ka kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Andaj sistemimi në një pozitë tjetër kur pozita paraprake vetëm është riemëruar, përbën shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të detyrohet Ministria e Punëve të Brendshme që të sistemoj në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Inspektimeve në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se në kohën kur është marr Vendimi me Nr. 94/2020 i datës 06.02.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për pezullimin nga puna të ankuesit, ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në kohën kur ankuesi është liruar nga akuza, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht sipas neni 7 paragrafi 1 dhe 2, ku është përcaktuar: *“1. Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas këtij ligji, nëpunësja/i civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësja/i civil transferohet në një pozitë tjetër*

të nivelit profesional. Ndërsa, për nëpunësen/ine nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nëpunësja/i kthehet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar”, ndërsa sipas nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, është përcaktuar: “1. Pas përfundimit të pezullimit, përveç kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, sipas LZP-së, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme të punës. 2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësi civil transferohet në një pozitë tjetër ekuivalente”.

Përkitazi me dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se pozita që ka mbajtur vetëm i është ndryshuar emërtimi dhe mënyra e raportimit dhe e cila ka kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe ka konstatuar se nëse i referohemi përgjigjes në ankesë të datës 02.07.2026, rezulton se pozita që ka mbajtur ankuesi para pezullimit nuk ekziston si pozitë në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Rregullores Nr.08/2026 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është krijuar Njësia për Inspektim, konkretisht me nenin 43 është paraparë Njësia për Inspektim e cila përbëhet nga katër divizione: *Divizioni për Inspektimin e Sigurisë së Aviacionit Civil, Divizioni për Inspektimet e Infrastrukturës Kritike, Divizioni për Inspektime për Armë, Eksplozivë, dhe Shërbime Private të Sigurisë dhe Njësia për Inspektimin e Regjistrimit Civil*, pra sipas kësaj rregulloreje nuk është paraparë asnjë pozitë me emërtimin Udhëheqës i Sektorit të Inspektimeve.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Inspektimeve është paraparë në kuadër të strukturës organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme sipas nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-240 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, ku përcaktohet: “1.Njësia e Inspektimit për Regjistrimin Civil themelohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pajtim me Ligjin përkatës për Inspektimet”, në këtë rast nuk mund të ngritet paralele sikurse pretendimet e ankuesit se pozita që ka mbajtur para pezullimit vetëm ka kaluar në Ministrinë e Punëve të Brendshme e cila është vazhdimësi e pozitës që ka mbajtur. Rrjedhimisht Njësia e Inspektimit, sipas Rregullores Nr. 08/2026 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht sipas Shtojcës Nr. 1, udhëhiqet nga Drejtori i Njesisë së Inspektimit që është pozitë e kategorisë së mesme drejtuese.

Për e tepër sipas provave të lëndës, ankuesi marrëdhënien e punës e ka themeluar në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil, dhe rrjedhimisht nëse i referohemi Ligjit Nr. 08/L-240 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, përkatësisht nenit 9, ku përcaktohet: “1.Drejtori Ekzekutiv e udhëheq dhe e përfaqëson ARC-në dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës, për: 1.1.propozimin e planit dhe raportit vjetor të performancës; 1.2.menaxhimin e burimeve njerëzore, në pajtim me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publik; 1.3.ekzekutimin e buxhetit dhe miratimin e pagesave, sipas legjislacionit përkatës për menaxhimin e financave publike; 1.4.lidhjen e kontratave në emër dhe për llogari të ARC, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi; 1.5.menaxhimin dhe administrimin e pronës së ARC; 1.6.çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet me ligj. 2. Drejtori Ekzekutiv nxjerr vendime me qëllim të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi nga fushëveprimtaria e ARC-së”, pra duke qenë se ankuesi ka pasur të themeluar marrëdhënie të punës në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil, atëherë sipas kompetencave Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil ka bërë sistemimin e ankuesit, por në asnjë formë nuk ka mundur të bëjë sistemimin në një pozitë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak që Agjencia e Regjistrimit Civil është institucion i veçantë edhe pse është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në këtë rast përveç kompetencave të përcaktuara me dispozitat si më lartë, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil, ka vepruar në pajtim me dhe me dispozitat e nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.

06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, e për rrjedhojë duke marr parasysh që pozita e ankuesit nuk është paraparë në kuadër të Agjencisë së Regjistrimit Civil, atëherë sistemimi i tij është bërë në një pozitë brenda institucionit ku ka pasur të themeluar marrëdhënie pune.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin ligjor të përcaktuar si më lartë, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar me ankesë gjegjësisht Vendimit Nr.73/2026, të datës 09.06.2026, të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrimin Civil, konstaton se akti i kontestuar nuk është përfshirë në shkelje procedurale dhe materiale, pasi që i njëjti është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesit nuk gjejnë mbështetje ligjore, rrjedhimisht vendimi i kundërshtuar është në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si i tillë nuk plotëson kushtet e paligjshmërisë së aktit administrativ të përcaktuar me nenin 52 të këtij ligji.

Andaj nga ajo qw u konstatua si mw lartw, e duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Kwshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.649/2026, më datë 27/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.M;
- Agjencisë së Regjistrimit Civil; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.